

**AKT THEMELIMI I SHOQERISE  
ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"EMIS." Sh.p.k.**



**Themelimi i Shoqërisë**

a. Sokol Besnik Çoku, i datëlindjes 1961, banues në Tiranë në Rrugën e Dibrës, Pallati 490/7, Shkalla 1, Ap. 4, vendosa të krijoj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "Emi S" sh.p.k. funksionimi i së cilës do të bazohet në rregullat e më poshtëme, si dhe në statutin e shoqërisë:

**Neni 1 - Emërtimi**

Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "Emi S." sh.p.k.

**Neni 2**

Shoqëria është krijuar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe do të fillojë aktivitetin e saj me rregjistrimin në rregjistrin tregtar.

**Neni 3**

Shoqëria do të veprojë në bazë të legjislacionit shqiptar dhe statutin e saj, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.

**Neni 4 - SELIA**

Selia e Shoqërisë do të jetë në Rrugën Bajram Curri, Tiranë. Shoqëria mund të krijojë degë, shoqëri të përbashkëta dhe shoqëri të tjera në Shqipëri ose jashtë saj, sipas nevojave që mund t'i dalin, si dhe të ndryshojë selinë e saj me vendim të ortakut të vetëm.

**Neni 5 - Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 20 vjet, duke filluar nga data e rregjistrimit në rregjistrin tregtar. Oretaku i vetëm mund të shtyjë kohëzgjatjen e shoqërisë, ose t'a shpërbëjë atë më parë se koha e caktuar në këtë akt.

**Neni 6 - OBJEKTI**

Tregtimi me shumicë dhe pakicë i mallrave të ndryshëm, eskport-import i tyre, investime.

**Neni 7 - KAPITALI FILLESTAR**

Kapitali fillestar i shoqërisë është 100,000 lekë dhe i përket ortakut të vetëm.

**Neni 8 - AMINISTRIMI**

Shoqëria do të administrohet nga një administrator i caktuar nga ortakut i vetëm. Administratori i shoqërisë do të jetë Sokol Çoku.

**Neni 9 - SHPERNDARJA**

Shpërndarja do të bëhet në çdo kohë që ortakut i vetëm e sheh të arësyeshme.

Ky akt themelimi nënshkruhet nga themeluesi i shoqërisë:

SOKOL ÇOKU

# STATUT I SHOQERISE "Emi S" SH.p.k.



## Neni 1

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Emi S" të cilës paskëtajt do t'i referohemi si Shoqëria, themelohet nga një ortak i vetëm Sokol Besnik Çoku, i datëlindjes 1961, banues në Tiranë në Rrugën e Dibrës, Pallati 490/7, Shkalla 1, Ap. 4.

## Neni 2

Shoqëria është themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe do ta fillojë veprimtarinë me regjistrimin në Regjistrin Tregtar.

## Neni 3

Selia e shoqërisë do të jetë në Rr. Bajram Curri. Me vendimin e ortakut të vetëm, Shoqëria mund ta ndryshojë selinë.

## Neni 4

Shoqëria do të veprojë në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe statutin e saj, në Shqipëri dhe jashtë saj. Shoqëria mund të krijojë përfaqësues të saj në vendet e tjera në përputhje me legjislacionet e tyre.

## Neni 5

Libri i shoqërisë.

Në mënyrë që të ruajë saktësisht veprimtarinë e saj ekonomike dhe marrëdhëniet e punës, shoqëria do të mbajë një libër që quhet Libri i Shoqërisë.

## Neni 6

Të gjitha dokumentet dhe aktet e tjera të nxjerra nga shoqëria dhe të cilat janë të destinuara për palët e treta, siç janë faturat, letrat, njoftimet dhe botime të tjera duhet të tregojnë qartë emrin e kompanisë dhe pastaj pas fjalëve shoqëri me përgjegjësi të kufizuar SH.p.k. kapitalin fillestar dhe emrin e administratorit.

## Neni 7

Objekti.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë: Tregtimi me shumicë dhe pakicë i mallrave të ndryshëm, eksport-importin e tyre, investime.

## Neni 8

Kohëzgjatja.


Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj për një kohë 20 vjeçare, duke filluar qysh nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar.

## Neni 9

Kapitali fillestar.

Kapitali fillestar i shoqërisë do të jetë 100.000 lekë dhe

*Sy*



përket ortakut të vetëm.

#### **Neni 10**

Kapitali fillestar mund të transferohet lirisht tek një palë e tretë. Transferimi i këtij kapitali tek një palë e tretë bëhet me vendim të pronarit të vetëm. Mënyra dhe procedura e kalimit të tij bëhet sipas nenit 47 të Ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Ai mund të transferohet lirisht në rastin e ndarjes së pasurisë ndërmjet bashkëshortëve ose në rast trashëgimie.

Transferimi i kapitalit fillestar duhet të vërtetohet nga noteri.

#### **Neni 11**

Mënyra e vlerësimit të kapitalit në natyrë bëhet sipas nenit 42 të Ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

#### **Neni 12**

Veprimtaria e shoqërisë do të ndiqet nga administratori, i cili i paraqet pronarit raportin, bilancin kontabël dhe llogaritë vjetore brenda 6 muajve pas mbylljes së vitit financiar në mënyrë që ortaku i vetëm të marrë vendim në lidhje me ndryshimet e domosdoshme në statut, ndryshimet në kapitalin fillestar ose shndërrimin e shoqërisë në një formë tjetër, punësimin e të punësuarve, pagat dhe problemet e tjera të lidhura me legjislacionin e Punës në Shqipëri.

#### **Neni 13**

Administratori i shoqërisë do të zgjidhet nga vetë ortakut i vetëm, dhe mund të shkarkohet po nga vetë ai.

#### **Neni 14**

Struktura legale dhe administrimi i shoqërisë.

Shoqëria do të konsiderojë selinë e saj si shoqëri mëmë, në rastin kur mund të zgjerohet me anën e degëve ose ndërmarrjeve të përbashkëta në të gjitha vendet ku është e nevojshme për të arritur objektivat e saj, brenda territorit apo jashtë territorit të Shqipërisë.

#### **Neni 15**


Viti financiar do të fillojë më 1 janar dhe do të mbyllet më 31 dhjetor të çdo viti, me përjashtim të vitit të parë që do të fillojë me regjistrimin në Regjistrin Tregtar dhe do të mbyllet më 31 dhjetor 1996.

#### **Neni 16**

Në mbyllje të vitit financiar ortakut i vetëm miraton bilancin vjetor, fitimin e realizuar gjatë vitit financiar, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm në qoftë se ka, rezervën e domosdoshme, e cila duhet të jetë jo më pak se 1/20 e fitimit sa të arrijë 1/10 e kapitalit fillestar, dhe fitimi që do të shpërndahet.



**Neni 17**



Shoqëria mund të shkrihet përpara mbarimit të afatit të saj të parashikuar në nenin 9 të këtij statuti, sipas procedurës së parashikuar në nenin 276 të Ligjit Nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare".

**Neni 18**

Shoqëria mund të ndahet ose shkrihet apo të bashkohet me shoqëri të tjera me miratim të ortakut të vetëm.

**Neni 19**

Ndryshimet e Statutit të Shoqërisë kërkojnë vendimin e ortakut të vetëm.

**Neni 20**

Për të gjitha çështjet e paparashikuara në këtë statut do të zbatohen dispozitat e Ligjit Nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare".

**Neni 21**

Dispozita përfundimtare.  
Ky statut është hartuar në pesë kopje.

Bërë në Tiranë, më datën 02.09.1996

**Ortaku i vetëm i Shoqërisë:**

Sokol Çoku

